



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

## FORUMI VII PËR ZHVILLIMIN E MEDIAS

### FJALA HAPËSE E KRYETARIT TË PREZENCËS Hotel “Rogner”, Tiranë, Salla “Antigonea I” 25 nëntor 2021

Shkëlqesi, zonja dhe zotërinj, të nderuar kolegë, të nderuar pjesëmarrës,

Ndihem mjaft mirë që jam sot mes jush, për një tjetër veprimtari të rëndësishme në fushën e medias.

Jam po aq i lumtur të theksoj angazhimin tonë për çështjen e lirisë së medias në Shqipëri, pasi e kemi shpallur këtë fushë pune prioritet të Prezencës sonë. Me organizimin e këtij aktiviteti të përvitshëm, siç thotë shprehja, qartazi i vendosim paratë aty ku flasim, duke qenë në përputhje me angazhimin tonë të deklaruar.

Përballemi me çështjet e medias me një qasje shumë profesionale, duke qenë të përqendruar në peizazhin mediatik shqiptar. Dhe jemi në një shoqëri shumë të mirë, Ambasadorja nga Këshilli i Evropës është këtu, kolegët e Delegacionit të BE-së, kolegët që janë lidhur online nga Vjena, nga Zyra e Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Medias – faleminderit për pjesëmarrjen Jurgen, përcilli respektet e mia Teresa Ribeiro-s – si dhe nga Gjeneva ku është përfaqësuesja e Unionit të Transmetuesve Evropian – shumë faleminderit edhe ju për pjesëmarrjen.

Ky është aktiviteti i dytë brenda dy muajsh që përqendrohet në çështje të lidhura me median. Siç mund ta mbani mend, në tetor, patëm nderin të presim Konferencën e Medias për Evropën Juglindore (SEEMC). Kujtojmë, se aty u diskutua për keqinformimin dhe gazetarinë cilësore hulumtuese, sigurinë dhe kushtet e punës së gazetarëve, përpjekjet për t’ia mbyllur gojën grave gazetare online, për gratë gazetare dhe ato drejtuese të medias – faktikisht, kjo e sotmja është një ditë thelbësore për gratë, në luftë kundër krimit të tmerrshëm të dhunës ndaj grave, për Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike si një kërcënim në rritje për median e pavarur, si dhe për të ardhmen e gazetarisë, pra, pikërisht për këndvështrimet e të rinjve për median.

Tashmë dhe këtu po vazhdojmë duke u përqendruar në dy tema konkrete, të cilat paraqiten qartë në rendin e ditës:

E para është **Zhvillimi i medias shqiptare**, ku do të diskutojmë një sërë këndvështrimesh mbi sfidat kryesore të lirisë dhe zhvillimit të medias me të cilat u përball Shqipëria gjatë viteve 2020-2021. Nxisim partneritetet pozitive dhe përdorimin e praktikave më të mira ndërkombëtare. Media, shoqëria dhe shteti duhet të angazhohen me njëri-tjetrin me një frymë sa më konstruktive që të jetë e mundur. Marr shkas këtu të përshëndes pjesëmarrjen në këtë aktivitet të zëdhënësit të Policisë, Z. Gentian Mullai. Kjo është një dëshmi e hapjes institucionale. Është një ftesë për dialog dhe bashkëpunim profesional. Përpjekja për të promovuar anën konstruktive është shtysa jonë kryesore për veprim në Prezencë, për të ndërtuar kapacitete që i mundësojnë mediave të arrijnë një standard të lartë profesionalizmi në raportim, të qëndrojnë të përshtatur me nevojat e shoqërisë, të hapen ndaj të rinjve. Përgjatë

këtyre linjave të veprimit, kemi punuar ngushtë me ju për të zhvilluar median shqiptare dhe presim rishtas nxitje vitin e ardhshëm.

E dyta është **gazetaria huluntuese dhe kontrolli i fakteve**; mendoj se është prioritet i pamohueshëm për Shqipërinë, por edhe një gjë së cilës shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së i kushtojnë vëmendje të veçantë, unë dhe ju gjithashtu.

Ne jemi këtu për të dëgjuar pikëpamjet tuaja rreth sfidave me të cilat përballeni dhe mundësive që sipas jush ekzistojnë për një gazetari huluntuese sa më cilësore dhe se si mund t'ju ndihmojmë në këto përpjekje.

Është përmes gazetarisë huluntuese cilësore dhe verifikimit të fakteve që media mund të japë një kontribut të ndjeshëm në kauzat madhore të shoqërisë, sikurse lufta kundër korrupsionit, duke i bërë institucionet shtetërore më të vetëdijshme për nevojat e shoqërisë dhe duke i afruar interesat e njerëzve me procesin e politikëbërjes.

Ndaj, na rrëfeni se si mund t'ju ndihmojmë që ta ktheni gazetarinë huluntuese cilësore në një standard të pakundërshtueshëm profesional, duke e kthyer verifikimin e fakteve në pjesë të përhershme të mjeteve të punës së gazetarit huluntuës. Faktikisht, kur mora pjesë në Vjenë në një ushtrim madhor të mbajtur në fillim të shtatorit, u vetëdijesova për faktin se sa e rëndësishme është gazetaria huluntuese për të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Dhe i premtova Shteteve pjesëmarrëse se do të kthehesha tek ata vitin e ardhshëm brenda të njëjtës strukturë, pra, brenda të njëjtit ushtrim, duke sjellë rezultate të prekshme. Kështu që kjo kërkon edhe angazhimin tim personal, sepse u zotova përpara Shteteve pjesëmarrëse.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe me vëmendje do të ndjek diskutimet konstruktive e të frytshme. **DO** të jenë veçanërisht të dobishme për mua, një person i cili edhe pse nuk është ekspert i medias është një konsumator i madh i saj.